

POLITIKA E PRIVATËSISË

TË PËRGJITHSHME

KIDS CLUB Shpk, është një subjekt i angazhuar maksimalisht në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me qëllim mbrojtjen e përdoruesit dhe klientëve gjatë aksesit dhe përdorimit të të dhënave personale.

Kjo politikë përmban termat e zbatueshme për ruajtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, në rast se ju:

1. Vizitoni web-in e www.kidsclub.al;
2. Aplikoni për informacion ose regjistrim pranë qendrës **KIDS CLUB**;
3. Kërkoni Informacion mbi përdorimin e të dhënave për fëmijët;
4. Aplikoni për punë pranë shoqërisë **KIDS CLUB Shpk**;
5. Lidhja me faqet e tjera elektronike;
6. Mbrojtja e të dhënave personale;
7. Siguria e Informacionit;
8. Si të na kontaktoni.

1. AKSESI NË FAQEN E INTERNETIT

1.1 Shoqëria **KIDS CLUB Shpk** disponon faqen www.kidsclub.al. Ju mund t`a vizitoni faqen tonë për arsye të ndryshme. Nëse thjesht shfletoni në mënyrë të përgjithshme faqen tonë, ne përmbledhim informacion në lidhje me kompjuterin tuaj dhe seksionet që vizitoni në faqen tonë në tërësi (jo informacione individuale ose personale). Këto të dhëna shpesh quhen të dhëna të klikimit ose të navigimit. Ne e përdorim këtë informacion për analizim dhe raportim, në mënyrë që të përmirësojmë lundrimin, strukturën dhe përmbajtjen e faqes sonë.

2. APLIKIM PËR REGJISTRIM OSE INFORMACION PRANË QËNDRËS SONË.

2.1 Disa rubrika të faqes sonë përmbajnë formularë që lejojnë të kërkoni informacion në lidhje me shërbimet tona në këmbim të informacionit të kontaktit ose të realizoni aplikime për regjistrim pranë qendrës sonë. Gjatë plotësimit të këtyre formularëve, mund t`ju kërkohet të jepni informacione kontakti, siç janë emri juaj, adresa, numri i telefonit dhe adresa e e-mailit. Duke plotësuar një formular në këtë faqe, ju pranoni politikën tonë të privatësisë. Ju pranoni gjithashtu që të dhënat tuaja mund të mos jenë subjekt i rregulloreve të BE-së, si p.sh Rregullorja (EU) 2016/679 (“GDPR”), pasi kjo është një kompani dhe një faqe që operon në Shqipëri.

3. INFORMACIONE PËR FËMIJËT

3.1 Duke qënë se shërbimi i ofruar nga shoqëria **KIDS CLUB** i referohet grupmoshave rreth 2-16 vjeç, sigurohemi që gjatë operimit të përditshëm të mbrojmë privatësinë dhe konfidencialitetin e të dhënave mbi fëmijët e regjistruar pranë qendrës sonë. Çdo informacion i nevojshëm për regjistrimin e fëmijëve merret nga prindërit dhe/ose përfaqësuesit e tyre dhe përpunohet me pëlqimin e shprehur të tyre. Informacionet që përdoren për efekt regjistrimi ruhen me konfidencialitet dhe privatësi të plotë dhe përdoren vetem nga personi i autorizuar nga kompania për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave personale. Kur fëmija c`regjistrohet nga qendra çdo informacion shkatërrohet ose i kthehet prindërve sipas kërkesës së shprehur të tyre.

4. INFORMACIONE TË AKSESUESHME GJATË APLIKIMIT PËR PUNË.

4.1 Kur individët aplikojnë për t'u punësuar pranë shoqërisë **KIDS CLUB Shpk**, ne përdorim informacionin për procesin e aplikimit, rekrutimit dhe përzgjedhjes së tyre. Të dhënat personale në lidhje me aplikantët e pasuksesshëm mbahen për një periudhë jo më shumë se 1 muaj pasi procesi i rekrutimit ka përfunduar, e më pas shkatërrohen. Kur një punonjës nuk është më në raporte pune me shoqërinë **KIDS CLUB**, për të ne përgatisim dokumentacionin në lidhje me periudhën gjatë së cilës ai ka qenë i punësuar dhe ia dorëzojmë punonjësit. Çdo e dhënë e përpunuar për shkak të statusit si “i punësuar” pranë shoqërisë sonë shkatërrohet ose i kthehet punonjësit, sipas kërkesës së shprehur të tij.

5. LIDHJET ME FAQET E TJERA

5.1 Kjo faqe mund të përmbajë lidhje elektronike me faqe të tjera në internet. Ju lutemi të mbani parasysh se ne nuk jemi përgjegjës për praktikatat e privatësisë së faqeve të tjera. Ne ju inkurajojmë që të lexoni deklaratat e privatësisë të secilës faqe në internet që mbledh të dhëna personalisht të identifikueshme. Kjo politikë e privatësisë zbatohet vetëm për të dhënat e mbledhura nga kjo faqe.

6. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

6.1 Mbrojtja e të dhënave personale bazohet në disa element thelbësorë:

- a) në përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.
- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e

tejkalojnë këtë qëllim;

ç) në saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen; duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej;

d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. **KIDS CLUBS Shpk** merr masa që çdo informacion i aksesuar, të përdoret sipas parimit të konfidencialitetit, legjitimitetit si dhe kufizimit të përdorimit të tyre duke u bazuar vetëm në qëllimin për të cilin janë mbledhur.

7. SIGURIA E INFORMACIONIT

7.1 Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përfshihet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një veprë penale.

8. SI TË NA KONTAKTONI

8.1 Kërkesat për informacion në lidhje me politikën tonë të privatësisë mund të dërgohen me e-mail në adresën: info@kidsclub.al.